



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 28.10.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.10.2021 të parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.P. Thesar ; Ndërmarrje Tregtare Shërbyese TINI, V.Qerqilli Nr. 51, -, SUHAREKË, Kosovë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Ndertimi I fushave sportive ne Komunen e Prishtines, me Nr. të Prok: 616-21-6486-5-2-1 dhe numër te brendshëm 616 21 137 521 nxjerr:**

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e **Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.P. Thesar ; Ndërmarrje Tregtare Shërbyese TINI, V.Qerqilli Nr. 51, -, SUHAREKË, Kosovë** të dt. 26.10.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Ndertimi I fushave sportive ne Komunen e Prishtines”**, me Nr. të Prok: **616-21-6486-5-2-1 dhe numër te brendshëm 616 21 137 521**, kundër *Njoftimit për tenderues te eliminuar te AK –së*, të datës 22.10.2021.

1. Vërtetohet Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim te aktivitetit te prokurimit
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj dhe te ritenderoj aktivitetin e prokurimit per tenderin* **“Ndertimi I fushave sportive ne Komunen e Prishtines”**, me Nr. të Prok: **616-21-6486-5-2-1 dhe numër te brendshëm 616 21 137 521**, sipas Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim te aktivitetit te prokurimit me datën: 22.10.2021.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.P. Thesar ; Ndërmarrje Tregtare Shërbyese TINI, V.Qerqilli Nr. 51, -, SUHAREKË, Kosovë me datë 26.10.2021, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Ndërtimi I fushave sportive ne Komunen e Prishtines”**, me Nr. të Prok: **616-21-6486-5-2-1** dhe numër te brendshëm **616 21 137 521**.

Autoriteti Kontraktues, me datë 28.10.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:
AK ka bere Njoftimin mbi Vendimin e Anulimit te aktivitetit te prokurimit gjithnje duke u mbeshtetur ne LPP dhe ne Rregullat dhe Udhezuesin e Prokurimit Publik.

Ne LPP dhe ne RRUOPP ne nenin 41 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, përkatësisht ne nenin 41.8 te RRUOPP shkruan:

41.8 AK do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës.

i. Ne rast se shuma e korigjuar është me pak se +/- 2%, AK do të përmirësoj gabimet e tilla dhe do të informoj me shkrim OE ne fjale duke përdorur formën standarde B49. Ne rast se OE ne fjale nuk pranon përmirësimin e gabimit, oferta ne fjale do të refuzohet. AK gjithashtu duhet ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës (OE të cilët kane dorëzuar tender) një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.

ii. Ne rast se shuma e korigjuar është me shume se +/- 2%, AK do të eliminoj OE dhe do të informoj me shkrim OE ne fjale duke përdorur formën standarde B42.

AK – komisioni i vleresimit, ka bere vleresimin e ofertave gjithnje duke u mbeshtetur ne LPP dhe ne Rregullat e Udhezuesit Operativ per prokurim Publik.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit